

14. 03
01 400 14303



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Në mes të:

Komunës së Glogocit

dhe

**Institutit për Politika Zhvillimore
(INDEP)**

Me anë të këtij Memorandumi, Komuna e Glogocit dhe Institutit për Politika Zhvillimore pajtohen të bashkëpunojnë në realizimin e objektivave të projektit: "Sustainably Developing Local Governments for Sustainable Developmnet Goals", projekt ky i financuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH – GIZ me fondet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë.

Qëllimi i bashkëpunimit

Komuna e Glogocit dhe Institutit për Politika Zhvillimore ndajnë të njëjtat vlera rreth idesë së zhvillimit të bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Projekti synon që të krijojë një hapësirë për dialog ne mes të shoqërisë civile dhe qeverisjes lokale drejt avancimit të Agjendës 2030 (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm). Po ashtu, si rezultat i këtij bashkëpunimi pritet të rritet vetëdija mbi rëndësinë e përmbrushjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në mesin e të gjithë hisëdarëve si dhe të draftohet Plani Lokal për Zhvillim të Qëndrueshëm i Komunës së Glogocit.

Bashkëpunimi në mes të komunës dhe Institutit INDEP arrihet me qëllim të bashkërendimet të përkushtimit dhe aktiviteteve të realizuara në këtë drejtim. Palët nënshkruese të këtij memorandumi pajtohen të shohin mënyra shtesë të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm si dhe të realizimit të objektivave finale të këtij memorandumi.


Obligimet e palëve nënshkruese

Ky Memorandum Bashkëpunimi vendosë bazat e bashkëpunimit në mes të Komunës së Glogocit dhe Institutit për Politika Zhvillimore. Pavarësisht obligimeve të marra me këtë memorandum, palët pajtohen që bashkëpunimi nuk do të kufizohet vetëm me elementet në vazhdim.

Komuna e Glogocit zotohet të:

- T'i siguroj qasje në dokumentët zhvillimore dhe të dhëna relevant për Komunën e Glogocit stafit të INDEP dhe ekspertëve të angazhuar në kuadër të këtij projekti;
- Të emëroj personin kontaktues për projektin me të cilin do të mbahet kontakt i vazhdueshë për mabrëvajtjen e projektit;

R. Li



- Të emërohen zyrtarët përgjegjës për sektorë të ndryshëm dhe ato/a të përfshirë në përpilimin e planeve lokale zhvillimore për të marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga INDEP për identifikimin e nevojave të Komunës së Gllogocit;
- Angazhim shështë sipas marrëveshjes paraprake.

INDEP zotohet të:

- Trajtoj me përgjegjësi dhe profesionalizëm të lartë të dhënrat e siguruara nga komuna;
- Siguroj ruajtjen e dhënavëve dhe shfrytëzimin e tyre vetëm për nevojat e këtij projekti;
- Të jetë transparent sa i përkët punës së vet dhe çfarëdo aktiviteti/angazhimi që ndërlidhet me Komunën e Gllogocit në kuadër të këtij projekti;
- Të komunikoj irregullisht me personin kontaktues mbi vijueshmërinë e projektit;
- Të organizoj një trajnim më zyrtarët komunal për të identifikuar nevojat kryesore të Komunës së Gllogocit dhe mundësitetë/sdifat për lokalizim të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm;
- Të draftoj Planin Lokal për Zhvillimin e Qëndrueshëm për Komunën e Gllogocit.

Kohëzgjatja

Ky memorandum bashkëpunimi zgjatë nëntë (9) muaj që nga data e nënshkrimit. Pas kësaj periudhe, palët pajtohen të rishikojnë rezultatet e e këtij bashkëpunii dhe bashkërisht të vendosin për hapat e mëtejme.

Gllogoc, 14 mars 2019



Kryetar, Komuna Gllogoc

Burim EJUPI

Drejtor Ekzekutiv, INDEP